



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Largimi drejt shteteve anëtare të BE-së:

shkaqet dhe pasojat e migrimit të fundit nga Kosova





QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Largimi drejt shteteve anëtare të BE-së: shkaqet dhe pasojat e migrimit të fundit nga Kosova

Tetor 2015

Botues:

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autor:

Plator Avdiu

Redaktimi i brendshëm:

Florian Qehaja

Redaktimi i jashtëm:

Shpend Kursani

Lekturimi në shqip:

Shemsi Haziri

Tetor 2015

Shënim: Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat për pronësi intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 2011/04-L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes, ose të transmetohet në ndonjë formë apo me ndonjë mjet elektronik, mekanik ose ndryshe, pa lejen paraprake të botuesit.

Mbështetja financiare dhe logjistike: Ky publikim është mbështetur nga Balkan Trust for Democracy në kuadër të Programit të Shkëmbimit të Punës Profesionale për Rritjen e Dialogut Politik, me mbështetjen e Zyrës për Punë të Jashtme dhe të Commonwealth-it të Mbretërisë së Bashkuar. Grupi 484 ka ofruar mbështetje logjistike për aktivitetet e këtij hulumtimi. Të gjitha pikëpamjet e shprehura në këtë studim janë vetëm të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe të autorit.

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	6
2. MIGRIMI NË KONTEKSTIN E LIBERALIZIMIT TË VIZAVE TË BE-SË ME KOSOVËN	7
3. SHKAQET E MIGRIMIT TË QYTETARËVE TË KOSOVËS DREJT BE-SË	15
3.1. Mungesa e perspektivës socio-ekonomike	15
3.2. Kontrabanda me emigrantë	18
3.3. Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Policisë së Serbisë	19
4. REKOMANDIME.....	21
BIBLIOGRAFIA	22
INTERVISTAT	26

1. HYRJE

Oferta e Bashkimit Evropian për regjim pa viza për vendet e Ballkanit Perëndimor ishte një nga premtimet kryesore politike për këto vende. Ky premtim ishte theksuar veçanërisht në qershor të vitit 2003, në Samitin BE-Ballkani Perëndimor në Selanik, i njohur gjerësisht si Agjenda e Selanikut. Regjimi pa viza përbën një nga “karotat” kryesore në procesin e para-anëtarësimit në Bashkimin Evropian me të cilin qytetarët e këtij rajoni do të ndjenin në mënyrë të drejtpërdrejtë dobinë nga Bashkimi Evropian. Përkundër interesimit të madh të shteteve të Ballkanit Perëndimor për të përfituar nga regjimi pa viza, Bashkimi Evropian ka paraqitur një sërë kushtesh që secili vend duhet t’i përmbushë në mënyrë që t’i hiqen vizat për të qarkulluar lirshëm në Zonën Shengen. Këto kushte kanë të bëjnë kryesisht me sundimin e ligjit, luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe migrimit ilegal, forcimit të kapaciteteve administrative në kontrollin kufitar dhe sigurinë e dokumenteve.¹

Në janar të vitit 2008, Komisioni Evropian i ftoi vendet e Ballkanit Perëndimor për të nisur dialogun për liberalizimin e vizave. Kjo ndodhi në kohën kur Kosova nuk e kishte shpallur pavarësinë, gjë që ndodhi rreth një muaj më vonë, më 17 shkurt 2008, dhe kështu nuk u ftua sikurse shtetet e tjera në procesin e dialogut për liberalizimin e vizave.² Kosova jo vetëm që mbeti jashtë këtij procesi, por BE-ja madje shtrëngoi regjimin e vizave për Kosovën, kur mori ven-

dimin për ta vendosur Kosovën në mesin e vendeve të treta, shtetasit e së cilës duhet të pajisen me vize për të kaluar kufijtë e jashtëm të shteteve anëtare të Zonës Shengen. Për më tepër, Kosova ishte vënë në listën e zezë për shkak të “shqetësimeve të sigurisë, veçanërisht në lidhje me mundësinë e migrimit të paligjshëm”³ nga Kosova për në BE dhe në shtetet anëtare të Zonës Shengen.

Pozita e Kosovës në raport me procesin e liberalizimit të vizave u përkeqësua edhe më shumë nga qëndrimi shumë i rreptë politik i disa prej shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën. Ky proces për Kosovën zyrtarisht nisi vetëm rreth katër vjet më vonë, pra në vitin 2012, kur Komisioni Evropian e ftoi Kosovën në dialogun për liberalizimin e vizave me Kosovën duke ia dorëzuar Qeverisë së Kosovës udhërrëfyesin drejt regjimit pa viza për Kosovën.

Ky punim trajton ndikimin e migrimit të qytetarëve të Kosovës në vendet e Bashkimit Evropian në kontekst të procesit të liberalizimit të vizave. Në të pasqyrohet progresi i arritur nga autoritetet e Kosovës, të cilin e mat Komisioni Evropian, në lidhje me plotësimin e kushteve të liberalizimit të vizave dhe në veçanti çështja e migrimit. Sfida më kryesore për Kosovën mbetet lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, si dhe migrimi i papritur në numër kaq të madh i qytetarëve të Kosovës gjatë viteve 2014 dhe 2015. Sipas të dhënave zyrtare statistikore, nga tetori i vitit 2014 deri në mars të vitit 2015, vlerëso-

1 (Council of the European Union, 2003, f. 16).

2 (Merja, 2012, f. 4).

3 (European Commission, 2009, fq. 7-8).

het se rreth 75,000⁴ qytetarë të Kosovës kanë migruar në Bashkimin Evropian, kryesisht në Hungari dhe Gjermani, përmes Serbisë. Rrjedhimisht, gjatë kësaj periudhe Kosova u radhit ndër pesë vendet kryesore nga ku vijnë kërkesat për azil në të paktën në njërin prej shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Migrimi i parregullt nga Kosova paraqet sfidë edhe për vet Kosovën, pasi që qëndrimi i Bashkimit Evropian është se numri i kërkesave për azil nga Kosova në Bashkimin Evropian duhet të bjerë para se të mund të rekomandohet heqja e vizave për Kosovën.

Ky punim synon të shpjegojë arsyet prapa fluksit të migrimit të fundit të qytetarëve të Kosovës drejt vendeve evropiane. Si pasojë e kësaj, hulumtimi ynë tregon se ekzistojnë tri arsye kryesore për valën e fundit të migrimit nga Kosova: (1) mungesa e perspektivës socio-ekonomike në Kosovë; (2) kontrabanda me emigrantë, dhe (3) mungesa e bashkëpunimit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit të Kosovës dhe Serbisë, gjegjësisht ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Policisë së Serbisë, për të luftuar krimin e organizuar dhe kontrabandën me emigrantë. Përveç faktorëve ekonomikë që duken se paraqesin arsyet kryesore për migrim, rritja e mprehtë e numrit të emigrantëve në BE konsiderohet të ketë ndodhur si pasojë e rrjeteve të kontrabandistëve që vepronin në Kosovë dhe Serbi, të cilët kontrabandonin emigrantët duke i sjellë në Bashkimin Evropian përmes rrugëve të ligjshme e të paligjshme nëpërmjet Serbisë. Për më tepër, nuk kishte pasur kurrfarë bashkëpunimi policor në mes të Kosovës dhe Serbisë për t'i luftu-

ar rrjetet e krimit të organizuar, gjë që mund të parandalonte migrimin e paligjshëm.

2. MIGRIMI NË KONTEKSTIN E LIBERALIZIMIT TË VIZAVE TË BE-SË ME KOSOVËN

Sipas Komisionit Evropian, Kosova ka përparuar në përmbushjen e kushteve të përcaktuara në udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave, edhe pse përpjekje të mëtejshme janë të domosdoshme⁵ në mënyrë që edhe ajo t'i bashkohet regjimit pa viza të Bashkimit Evropian (BE). Udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave për Kosovën mendohet të jetë i ndryshëm në disa aspekte nga udhërrëfyesit e mëparshëm për vendet tjera të Ballkanit Perëndimor. Në të vërtetë, Kosova duhet të përmbushë shumë më tepër kushte sesa vendet tjera të rajonit. Përderisa vendet tjera të Ballkanit Perëndimor kanë pasur 40 deri 50 kushte për t'i përmbushur, udhërrëfyesi për Kosovën është përbërë prej rreth 100 kushteve që duhen plotësuar sa i përket heqjes së regjimit të vizave me BE-në⁶. Përveç kësaj, Komisioni Evropian, në bashkëpunim me Këshillin e BE-së dhe shtetet anëtare të BE-së, ka të drejtë, nëse është e nevojshme, ta ndryshojë udhërrëfyesin⁷, që do të thotë të shtojë më shumë kushte për Kosovën⁸. Kjo është bërë,

5 (European Commission, 2014a, f. 8).

6 (Garaiova & Merja, 2012, f. 17).

7 (European Union Office in Kosovo, 2012, f. 3).

8 (Garaiova & Merja, 2012, f. 19).

4 Për më shumë hollësi, shih raportet e Eurostat-it lidhur me kërkesat për azil në vitet 2014 dhe 2015.

Shkalla e refuzimit të vizave për qytetarët e Kosovës në 28 Shtetet Anëtare të BE-së, 2012-2013




Figura 1 - Shkalla e refuzimit të vizave për qytetarët e Kosovës në 28 Shtetet Anëtare të BE-së, 2012-2013¹¹

ndoshta, edhe për shkak të përvojës së BE-së me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor që kanë përmbushur kriteret sipas perspektivës “sa për të rrumbullakuar përgjigjet”, pra pa zbatim të rreptë të kushteve në terren. Kjo ka bërë që zyrtarë të lartë të institucioneve të Kosovës në vazhdimësi të deklarojnë se BE-ja po zbaton “standarde të dyfishta”, në mënyrë të veçantë kur bëhet fjalë për kushtet e liberalizimit të vizave për Kosovën⁹. Pavarësisht kësaj, autoritetet e Kosovës shpresojnë se nuk do të ketë më kushte të tjera nga Komisioni Evropian në lidhje me udhërrëfyesin ekzistues për liberalizimin e vizave.

Deri më tani, Komisioni Evropian ka bërë dy vlerësime për identifikimin e sfidave që Qeveria e Kosovës duhet t’i adresojë në mënyrë që të shënojë përparim në drejtim të regjimit pa viza. Duke u përqendruar në çështjet e migrimit, ky raport do të shqyrtojë vetëm vlerësimin e Komisionit Evropi-

an për ndikimin e migrimit në liberalizimin e vizave me Kosovën. Sfidat kryesore që Komisioni Evropian i ka përmendur në këtë drejtim mbeten: (1) parandalimi i efektshëm dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit; (2) rritja e numrit të emigrantëve të rregullt dhe të parregullt; dhe (3) kontrabanda me qenie njerëzore¹⁰. Gjatë viteve 2012 dhe 2013, Komisioni Evropian ka vënë re se ka pasur rritje të dukshme në treguesit në vijim sa i përket migrimit: 1) në shkallën e refuzimit të vizave për qytetarët e Kosovës në Zonën Shengen dhe më saktësisht në shtetet anëtare të BE-së; 2) në rritjen e shkallës së migrimit të paligjshëm të qytetarëve të Kosovës drejt shteteve anëtare të BE-së; dhe 3) në rritjen e shpejtë të numrit të kërkesave për azil që janë paraqitur nga qytetarët e Kosovës në të paktën në njërin prej shteteve anëtare të BE-së.

Të dhënat statistikore tregojnë se shkalla e refuzimit të vizave për qytetarët e Kosovës nga ambasadat e shteteve anëtare të BE-

⁹ Intervistë me zëvendësministrin e Integritimit Evropian të Kosovës, Ramadan Ilazi, më 13 mars 2015.

¹⁰ (European Commission, 2014b, f. 15).

¹¹ (European Commission, 2014b, f. 18).




Figura 2 - Migrimi i paligjshëm dhe kërkesat për azil nga qytetarët e Kosovës në 28 shtetet e BE-së, 2012-2013¹³

së në Kosovë është rritur nga 625 në vitin 2012, në 1,400 në vitin 2013¹². Megjithatë, nuk ka të dhëna zyrtare për periudhën pasuese, për vitet 2014 dhe 2015 (tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2015), për të treguar nëse ky trend ka vazhduar të pësojë ngritje ose rënie.

Rritja e shkallës së refuzimit të vizave u pasua edhe nga rritja e numrit të emigrantëve të paligjshëm dhe azilkërkuesve nga Kosova për në shtetet anëtare të BE-së. Numri i qytetarëve të Kosovës që qëndronin në mënyrë të paligjshme në BE midis viteve 2012 dhe 2013 u rrit për 51 për qind, nga 5,200 në vitin 2012 në 7,870 në vitin 2013, ndërsa Hungaria ishte raportuar të jetë destinacioni i numrit më të madh të emigrantëve të paligjshëm nga Kosova. Ngjashëm sikur me emigrantët e paligjshëm,

edhe numri zyrtar i azilkërkuesve është rritur gjatë periudhës së njëjtë. Numri i qytetarëve të Kosovës që kërkuan azil në BE gjatë këtyre dy viteve u rrit për 98 për qind, pra nga 10,205 në vitin 2012 në 20,215 në vitin 2013. Edhe këtë herë, Hungaria ishte destinacioni kryesor, ku qytetarët e Kosovës kërkuan azil gjatë kësaj periudhe.

12 (European Commission, 2014b, f. 18).

13 (European Commission, 2014b, fq. 19-20).




Figura 3 – Kërkesat për azil nga Kosova në 28 Shtetet Anëtare të BE-së – gjithsejtë prej 12 muajve dhe e zbrëthyer në katër periudhat tremujore të vitit 2014¹⁴

Numri i azilkërkuesve ka vazhduar të rritet në vitin e ardhshëm. Shifrat e mësipërme tregojnë numrin e azilkërkuesve nga Kosova në baza tremujore për vitin 2014. Gjysma e parë e vitit 2014 nuk ka treguar ndonjë rritje të madhe të numrit të azilkërkuesve. Megjithatë, duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2014, numri i azilkërkuesve është rritur dukshëm. Numri i azilkërkuesve është rritur në tremujorin e tretë të vitit 2014, duke shënuar rritje të madhe në tremujorin e fundit të vitit 2014. Sipas të dhënave të Eurostat-it, gjithsej 25,880 azilkërkues ishin regjistruar vetëm gjatë tremujorit të katërt të vitit 2014, që paraqet një numër më të lartë se të tre tremujorët e mëparshëm së bashku.¹⁴

Në të vërtetë, numri i atyre që kanë kërkuar azil gjatë tremujorit të fundit (tetor, nëntor dhe dhjetor) të vitit 2014 përbën rreth 68 për qind të azilkërkuesve për tërë vitin 2014. Numri në përmasa marramendëse i azilkërkuesve nga Kosova gjatë tremujorit të fundit të vitit 2014 ka renditur Kosovën si vendin e tretë të azilkërkuesve në vitin 2014 në shtetet anëtare të BE-së, pas Sirisë dhe Afganistanit.

¹⁴ (Eurostat, 2015a, f. 5). TM1 përfshin muajt janar, shkurt dhe mars; TM2 përfshin muajt prill, maj dhe qershor; TM3 përfshin muajt korrik, gusht dhe shtator; dhe TM4 përfshin tre muajt e fundit të vitit 2014, domethënë tetorin, nëntorin dhe dhjetorin.

Kërkesat për azil nga Kosova në 28 shtetet e BE-së nga janari deri në dhjetor të vitit 2014




Figura 4 – Kërkesat për azil nga Kosova në 28 Shtetet Anëtare të BE-së në baza mujore nga janari deri në dhjetor të vitit 2014¹⁵

Sipas figurës së mësipërme, shihet në mënyrë të qartë se nga janari deri në gusht, migrimi i qytetarëve të Kosovës në vendet evropiane ka qëndruar në normën prej rreth +/- 1,000 kërkesa për azil për çdo muaj. Gjatë muajve shtator dhe tetor u bë ndry-

shimi rrënjësor i këtij trendi, me rreth 8,000 azilkerkues të regjistruar në nëntor dhe më shumë se 13.000 sosh në muajin dhjetor. Vetëm në dy muajt e fundit të vitit 2014, më shumë qytetarë kërkuan azil sesa në 10 muajt e mëparshëm të marrë së bashku.

Tabela 1 - Kërkesat për azil nga Kosova sipas vendit të destinacionit në 28 shtetet anëtare të BE-së - gjithsej dhe e zërthyer në tremujorin e katërt të vitit 2014

Vendi i destinacionit	Janar-Dhjetor 2014 ¹⁶	Tetor-Dhjetor 2014 ¹⁷
Hungari	21,455	17,880
Gjermani	8,920	4,750
Francë	2,735	800
Austri	1,905	1,350
Suedi	1,480	640
Të tjera	1,380	460
Gjithsej	37,875	25,880

15 (Eurostat, 2015a, f. 5).

16 (Eurostat, 2015a, f. 9).

17 (Eurostat, 2015a, f. 19).

Siç tregon kjo tabelë e mësipërme, Hungaria dhe Gjermania spikaten në listën e vendeve të destinacionit, ku emigrantët e Kosovës janë regjistruar për kërkesa për azil në vitin 2014. Nga gjithsej 37,875 kërkesa për azil, 21,455 prej tyre u raportua se kanë kërkuar azil në Hungari dhe 8,920 të tjerë në Gjermani. Në mënyrë të ngjashme, vetëm gjatë muajve tetor-dhjetor të të njëjtit vit, kur numri i emigrantëve nga Kosova filloi të rritet me shpejtësi, pothuajse 18,000 azilkërkues të Kosovës u regjistruan në Hungari dhe pothuajse 5,000 prej tyre në Gjermani. Vendet tjera evropiane, ku qytetarët e Kosovës zgjodhën të emigrojnë, ishin: Franca, Austria dhe Suedia, ndonëse këto vende pranuan numër dukshëm më të vogël të azilkërkuesve në krahasim me Hungarinë dhe Gjermaninë.

Të dhënat statistikore të Eurostat-it për vitin 2015 tregojnë se migrimi i qytetarëve të Kosovës në BE arriti kulmin në tremujorin e parë të vitit 2015. Në mesin e vendeve të BE-së, Hungaria dhe Gjermania vazhduan të pranojnë numrin më të madh të emigrantëve gjatë kësaj periudhe. Sipas këtyre të dhënave, 48,875 qytetarë emigruan në shtetet anëtare të BE-së nga janari deri në mars 2015. Më saktësisht, nga numri i përgjithshëm i emigrantëve, 22,830 prej tyre shkuan në Hungari dhe 21,095 në Gjermani. Vende të tjera të destinacionit për emigrantët ishin: Austria, Franca, Suedia etj.




Figura 5 - Kërkesat për azil nga Kosova në 28 shtetet e BE-së sipas vendit të destinacionit nga janari deri në mars të vitit 2015¹⁸

¹⁸ (Eurostat, 2015b).


Tabela 2 - Azilkërkuesit e Kosovës në 28 shtetet e BE-së nga tetori 2014 deri në mars 2015

Vendi i destinacionit	Tetor-Dhjetor 2014 ¹⁹	Janar-Mars 2015 ²⁰	Numri i përgjithshëm nga tetori 2014 deri në mars 2015
Hungari	17,880	22,830	40,710
Gjermani	4,750	21,095	25,845
Austri	1,350	2,065	3,415
Francë	800	1,535	2,335
Suedi	640	825	1,465
Të tjera	460	525	985
Gjithsej	25,880	48,875	74,755

Analizimi i të dhënave krahasuese, sipas tabelës së mësipërme, për tremujorin e fundit të vitit 2014 dhe tremujorin e parë të vitit 2015, tregon se shkalla e kërkesave për azil ka vazhduar të rritet - edhe përkundër faktit se tremujori i fundit të vitit 2014 shënoi periudhën më të lartë të migrimit nga Kosova në vendet e BE-së, në anën tjetër tremujori i parë i vitit 2015 shënoi rritje edhe më të lartë të azilkërkuesve. Në të vërtetë, numri i azilkërkuesve të regjistruar në tremujorin e parë të 2015 (48,875 azilkërkues) ishte rreth

89 për qind më i lartë sesa në tremujorin e fundit të vitit 2014 (25,880 azilkërkues). Prandaj, vetëm gjatë periudhës ndërmjet tetorit 2014 dhe marsit 2015, kishte më shumë se 74,755 emigrantë të Kosovës, të cilët kërkuan azil në njërin nga shtetet anëtare të BE-së. Duke pasur parasysh se ky numër paraqet vetëm ata emigrantë që zyrtarisht kanë kërkuar azil, atëherë del që numri i përgjithshëm i emigrantëve, të cilët vazhdojnë të qëndrojnë në mënyrë të paligjshme është shumë më i lartë se 75,000 sosh.²¹

Dhjetë shtetet e para të radhitura sipas kërkesave për azil në 28 shtetet e BE-së nga janari deri në mars të vitit 2015

Figura 6 - Dhjetë vendet e para të radhitura për nga numri i qytetarëve që kanë kërkuar azil në 28 shtetet e BE-së nga janari deri në mars të vitit 2015 (TM1 2015)²²

19 (Eurostat, 2015a, f. 19).

20 (Eurostat, 2015b).

21 (Möllers, Arapi-Gjini, Xhema, & Herzfeld, 2015, f. 1).

22 (Eurostat, 2015c).

Sipas kësaj figure, gjatë tremujorit të parë të vitit 2015 (janar, shkurt dhe mars) emigrantët nga Kosova janë radhitur në vendin e parë, kur bëhet fjalë për kërkesat për azil nga qytetarët e saj në shtetet anëtare të BE-së. Me gjithsej prej 48,875 kërkesave për azil apo 26 për qind të numrit të përgjithshëm të kërkesave për azil për herë të parë në BE, Kosova ka shënuar numrin më të madh të emigrantëve në BE për periudhën përkatëse tremujore. Pas Kosovës vjen Siria (29,100 ose 16 për qind), Afganistani (12,910 ose 7 për qind), Shqipëria (8,140 ose 4 për qind), Iraku (7,295 ose 4 për qind), Serbia (6,335 ose 3 për qind), Pakistani (5,310 ose 3 për qind) dhe vendet tjera.

Edhe para se të ndodhë vala e madhe e migrimit, numri i madh i emigrantëve nga Kosova që shkojnë drejt vendeve të BE-së është përmendur vazhdimisht nga Komisioni Evropian si një nga shqetësimet kryesore të BE-së në lidhje me procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën. Në vlerësimet e veta, Komisioni Evropian ka konstatuar se rënia e konsiderueshme sa i përket migrimit dhe numrit të azilkërkuësve nga Kosova, do të përdoret si një tregues pozitiv kur bëhet fjalë për liberalizimin e regjimit të vizave të Kosovës²³. Zyrtarë të lartë të BE-së kanë theksuar se numri i kërkesave për azil në BE dhe numri i qytetarëve që qëndrojnë në mënyrë të parregullt në Zonën Shengen duhet të bjerë para se të rekomandohet për Kosovën heqja e vizave²⁴. Në vizitën e tij në Kosovë në mars të vitit 2015, Komisionari i BE-së për Migrim, Punë të Brendshme dhe Shtetësi, Dimitris Avramopoulos, kërkoi që institucionet në Kosovë të dëshmojnë rezu-

ltate konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, veçanërisht në rastet e profilit të lartë në Kosovë. Ai ka qartësuar se për t'i dhënë Kosovës regjimin pa viza duhet të ketë "masa të jashtëzakonshme" për të parandaluar migrimin e paligjshëm të qytetarëve të Kosovës në shtetet anëtare të BE-së. Sidoqoftë, ai gjithashtu solli porosi pozitive për Kosovën, duke shprehur pikëpamjen e tij optimiste se Qeveria e Kosovës është duke ecur në "miljen e fundit drejt statusit pa viza" dhe konstatoi se Kosova nuk është larg nga dita kur BE-ja duhet ta shpallë datën kur do liberalizohen vizat²⁵. Pavarësisht nga retorika të tilla nga ana e zyrtarëve të BE-së, qëndrimi zyrtar i BE-së është se nuk do të ketë afat të caktuar se kur do të fillojë regjimi pa viza për Kosovën. Për shembull, menjëherë pas deklaratës së Avramopoulos-it, Komisionari i BE-së për Politikën e Fqinjësisë Evropiane dhe të Negociatave për Zgjerim, Johannes Hahn, ka bërë të qartë gjatë vizitës së tij në Kosovë, se pa përmbushjen e "kushteve të caktuara" nga ana e institucioneve të Kosovës në lidhje me udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave, qytetarët e Kosovës nuk do të udhëtojnë lirshëm brenda BE-së.²⁶

Në anën tjetër, përfaqësues të lartë të Kosovës që janë përgjegjës për integrimin evropian kanë përsëritur se Kosova është duke marrë parasysh rekomandimet e BE-së në mënyrë që të përmbushë të gjitha

25 Deklarata e Komisionarit të BE-së për Migrim, Punë të Brendshme dhe Shtetësi, Dimitris Avramopoulos në Prishtinë gjendet në: <https://www.youtube.com/watch?v=BSt6Sa0wtNs>. Gjetur më 14 mars 2015.

26 Deklarata e Komisionarit të BE-së për Politikën e Fqinjësisë Evropiane dhe Negociatave për Zgjerim, Johannes Hahn në Prishtinë gjendet në: https://www.youtube.com/watch?v=IMjJt_Gaxll. Gjetur më 25 mars 2015.

23 (European Commission, 2014b, f. 15).

24 (European Commission, 2015b).

kushtet për të marrë liberalizimin e vizave. Në qershor të vitit 2015, në Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë/Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian në Kosovë, ministri i Integritimit Evropian të Kosovës dorëzoi raportin mbi përmbushjen e kushteve për liberalizimin e vizave²⁷. Përveç kësaj, zyrtarët e lartë të Qeverisë së Kosovës kanë pranuar se migrimi i paligjshëm do të ketë ndikim negativ gjatë vlerësimit të Komisionit Evropian në lidhje me përmbushjen e kushteve të procesit të liberalizimit të vizave. Për më shumë, Ministria e Integritimit Evropian nuk pret që Kosova të hyjë në regjimin pa viza të BE-së në vitin 2015, duke marrë parasysh kushtet që duhet të përmbushen, si dhe për shkak të mungesës së progresit në këtë proces gjatë tre muajve të parë të vitit 2015²⁸.

3. SHKAQET E MIGRIMIT TË QYTETARËVE TË KOSOVËS DREJT BE-SË

Migrimi i qytetarëve të Kosovës në vendet evropiane nuk është fenomen i ri. Faktorët dhe motivet që kanë shtyrë qytetarët të emigrojnë në vendet evropiane janë në mënyrë të qartë ato për çështje ekonomike. Megjithatë, me përjashtim të pakënaqësisë me rrethanat ekonomike dhe shoqërore, ka edhe arsye tjera që ndërlidhen me migrimin. Ky hulumtim radhit si në vijim shkaqet kryesore të migrimit të qytetarëve të Kosovës në vendet evropiane.

3.1. Mungesa e perspektivës socio-ekonomike

Arsyeja më kryesore për migrim është pakënaqësia e qytetarëve të Kosovës me gjendjen aktuale të perspektivës socio-ekonomike dhe me nivelin e përgjithshëm të mirëqenies. Kosova po përballet me shkallë të lartë të papunësisë, sidomos në mesin e të rinjve dhe përqindja e njerëzve që jetojnë nën nivelin e varfërisë është e lartë. Sipas të dhënave më të fundit, nga fuqia aktive punëtore në Kosovë prej moshës 15 deri në 64 vjeç, 35.3 për qind prej tyre ishin të papunë në vitin 2014²⁹. Ky problem është i theksuar veçanërisht në mesin e të rinjve, pasi që vlerësohet se 61.0 për qind e të rinjve të Kosovës janë të papunë³⁰. Situata është e zymtë edhe kur është fjala për nivelin e varfërisë. Sipas të dhënave statistikore të vitit 2013, 29.7 për qind e qytetarëve të Kosovës jetojnë nën nivelin e varfërisë³¹, ndërsa 10.2 për qind e popullsisë së Kosovës jeton nën nivelin e varfërisë së skajshme.^{32 33}

Çështjet ekonomike që lidhen me papunësinë janë ndër shqetësimet kryesore të qytetarëve të Kosovës. Hulumtimet e fundit të opinionit publik në Kosovë tregojnë se ndër kërcënimet e sigurisë kombëtare me të cilat përballet Kosova i përkasin karakterit ekono-

29 (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2015, f. 10).

30 (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2015, f. 10).

31 Sipas përkufizimit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, niveli i varfërisë në vitin 2011 ishte 1.72 euro për të rritur në ditë (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013, f. 3). Nuk ka të dhëna në lidhje me varfërinë e konsumit në Kosovë për vitet e mëvonshme, përkatësisht 2012, 2013, 2014 dhe 2015.

32 Në vitin 2011 niveli i varfërisë së skajshme në Kosovë ishte 1.20 euro për të rritur në ditë (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013, f. 3).

33 (Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2013, fq. 3-4).

27 (Ministria e Integritimit Evropian të Kosovës, 2015).

28 (Kqiku, 2015).




Figura 7 – Sipas mendimit tuaj, cilat janë çështjet më të rëndësishme me të cilat ballafaqohet Kosova në këtë moment? 1 = më e rëndësishme dhe 10 = më së paku e rëndësishme³⁵

mik. Sipas këtyre të dhënave, 77,4 për qind e të anketuarve besonin se shkalla e lartë e papunësisë është kërcënimi më i madh për Kosovën³⁴. Duke marrë parasysh shkallën e lartë të papunësisë dhe numrin e madh të njerëzve që jetojnë nën nivelin e varfërisë dhe nën nivelin e varfërisë së skajshme, migrimi shihet si një mundësi nga ana e qytetarëve të Kosovës për të gjetur një perspektivë më të mirë shoqërore dhe ekonomike jashtë vendit, veçanërisht në shtetet anëtare të BE-së. Sipas një anketimi të opinionit publik në Kosovë në vitin 2014, në mesin e shumë shqetësimeve tjera gjatë viteve 2012-2014, tri çështjet më të rëndësishme dhe më shqetësuese për qytetarët e Kosovës kanë qenë: (1) lufta kundër

korrupsionit; (2) gjendja ekonomike në përgjithësi; dhe (3) papunësia në vend.

Azilkërkuesit nga vala e fundit e migrimit, të cilët u detyruan të rikthehen në Kosovë kanë përmendur se arsyet kryesore për të migruar ishin (1) papunësia, (2) kushtet e vështira socio-ekonomike, dhe (3) vështirësitë për të gjetur punë³⁶. Vala e fundit e migrimit është quajtur "tragjedi njerëzore"³⁷ nga zyrtarët e Qeverisë së Kosovës, të cilët kanë pranuar se ky fenomen është shkaktuar kryesisht nga mungesa e perspektivës ekonomike në vend. Sidoqoftë, kryeministri i Kosovës, çu-

34 (Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2014, f. 16).

35 (EU Perspective in Kosovo & UBO Consulting, 2014, f. 28).

36 Intervistë me FR, azilkërkues i Kosovës, më 12 mars 2015.

37 Intervistë me zëvendësministrin e Integritimit Evropian të Kosovës, Ramadan Ilazi, më 13 mars 2015.

ditërisht ishte shprehur se qytetarët nuk u larguan nga vendi drejt shteteve të BE-së si pasojë e kushteve të vështira. Për më tepër, sa i përket valës masive të migrimit nga Kosova, ai përmendi se emigrantët kishin rroga të mira³⁸. Në anën tjetër, zyrtarët e BE-së, ndonëse tërthorazi, i kanë bërë përgjegjëse institucionet e Kosovës për migrimin, duke konstatuar se fokusi duhet të vihet tek zhvillimi ekonomik i Kosovës, duke theksuar se qytetarët të cilët po largohen nga vendi po e bëjnë këtë për shkak të mungesës së perspektivës ekonomike³⁹. Për më tepër, BE-ja ka sqaruar se kërkesat për azil nga Kosova do të refuzohen, pasi që sistemi i azilit të BE-së ekziston vetëm për të ndihmuar njerëzit që largohen nga persekutimi ose dëmtimi i rëndë në vendet e tyre dhe kur ata kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, por në asnjë mënyrë për arsye ekonomike.⁴⁰

Megjithatë, zyrtarët e BE-së kanë premtuar ndihmë financiare për të nxitur ekonominë e Kosovës, duke siguruar rreth 660 milionë euro për periudhën nga viti 2014 deri në vitin 2020⁴¹. Për t'u ballafaquar me këtë situatë, Kuvendi i Kosovës, në shkurt të vitit 2015, miratoi Rezolutën për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës. Rezoluta përmban një sërë rekomandimesh në adresë të Qeverisë së Kosovës për të ndërmarrë masa, veçanërisht në lidhje me zhvillimin ekonomik. Aty bëhet thirrje për krijimin

e fondit për pengimin e migrimit ilegal, angazhim më të madh nga qeveria, me theks të veçantë në shtimin e vendeve të reja të punës për qytetarët e Kosovës, si dhe arritjen e marrëveshjeve me vendet e Evropës për punësim sezonal të qytetarëve të Kosovës⁴².

Përveç kësaj, ideja e punësimit sezonal kishte qenë alternativë ndaj migrimit që po ndodhte edhe nga Serbia. Kjo përfshinte procesin e arritjes së marrëveshjeve ndërkombëtare përkatëse midis Serbisë dhe shteteve anëtare të BE-së që do të mundësonin punësimin e përkohshëm sezonal të qytetarëve të Serbisë, veçanërisht të punëtorëve të pakualifikuar dhe me kualifikim të ulët, në përputhje me nevojat e tregut të punës të shteteve anëtare të BE-së⁴³. Kjo mënyrë e luftimit të migrimit të paligjshëm nga Kosova ishte konsideruar pozitivisht edhe nga Johannes Hahn, Komisionar i BE-së për Politikën e Fqinjësisë Evropiane dhe Negociatave për Zgjerim⁴⁴.

Prandaj, problemet e papunësisë dhe të gjendjes së rëndë socio-ekonomike në Serbi dhe Kosovë duhet të shihen si problem rajonal dhe duhet të trajtohen në këtë rrafsh për gjetjen e zgjidhjeve ndërmjet BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, në mënyrë të veçantë të Kosovës.

42 (Kuvendi i Kosovës, 2015, fq. 1-2).

43 (Group 484 & Nexus, 2012, f. 64). Punësimi sezonal për migrimin e parregullt të Serbisë ishte rekomanduar nga Grupi 484 në vitin 2012. Sipas statistikave të Eurostat-it, Serbia në vitin 2014 është radhitur e pesta për kah numri i kërkesave për azil të qytetarëve të saj në vendet e BE-së (Eurostat, 2015a, f. 8). Përveç kësaj, trendi i migrimit të qytetarëve serbë për të kërkuar azil në Shtetet Anëtare të BE-së vazhdoi dhe masat që ka marrë qeveria serbe deri më tani nuk kanë çuar në ndonjë zgjidhje të duhur.

44 (Zyra e Kryeministrit të Kosovës, 2015).

38 Për më shumë hollësi lidhur me qëndrimin e kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa për migrimin, shih raportimet e mediave të Kosovës në: <http://www.telegrafi.com/lajme/mustafa-nuk-kam-shkuar-te-stacioni-i-autobuseve-sepse-ata-qe-iknin-kishin-edhe-iphone-2-58794.html>. Gjetur më 27 shkurt 2015.

39 (European Commission, 2015a).

40 (European Union Office in Kosovo, 2015).

41 (European Commission, 2015a).

3.2. Kontrabanda me emigrantë

Rritja e mprehtë e numrit të emigrantëve në BE konsiderohet të ketë ndodhur si pasojë e rrjeteve kriminale të kontrabandistëve që vepronin në Kosovë dhe Serbi që merreshin me kontrabandë të emigrantëve duke i dërguar në BE përmes rrugëve të paligjshme të Serbisë. Sa i përket shkaqeve, ky shkak i veçantë është i ndërlidhur me çështjen paraprake: po të mos ekzistonte shkak i mëparshëm (ekonomik) që i shtyri njerëzit të emigrojnë, do të kishte gjasa të larta që kontrabanda me emigrantë të mos ndodhte fare. Itinerari i emigrantëve të Kosovës për në vendet e BE-së ishte si vijon: ata hipnin në autobusë nga Kosova (në Prishtinë, Ferizaj, Prizren dhe qytete të tjera) për në Beograd dhe më pas mbërrinin në destinacionin e tyre të ardhshëm që ishte Subotica (një qytet serb në afërsi të kufirit me Hungarinë). Në të vërtetë, qytetarët e Kosovës mund të shkojnë në Serbi nga Kosova me letërnjoftimet e Kosovës sipas Marrëveshjes së Brukselit të vitit 2011 për Lirinë e Lëvizjes në mes të Kosovës dhe Serbisë⁴⁵. Duke e ditur që qytetarët e Kosovës kanë nevojë për vizë për të hyrë në Hungari, që është shtet në Zonën Shengen, shumica e qytetarëve të Kosovës, të cilët nuk ishin të pajisur me vizë Shengen kaluan kufirin ndërmjet Serbisë dhe Hungarisë në mënyrë të paligjshme, që do të thotë pa vizë. Kjo ishte një mënyrë shumë më e lirë për të emigruar në një shtet anëtar të BE-së, në krahasim me mënyrën ligjore, për shembull duke paguar për vizë dhe biletat e fluturimit, të cilat kërkohen zakonisht nga konsullatat në Kosovë para se të aplikohet

për vizë. Prandaj, vet regjimi i vizave i BE-së ndaj Kosovës i ka shtyrë qytetarët e Kosovës të gjejnë mënyra të paligjshme për të hyrë në shtetet përkatëse anëtare të BE-së dhe Zonës Shengen.⁴⁶

I intervistuar për qëllime të këtij hulumtimi, një qytetar i Kosovës, i cili ka dështuar në kërkesën e tij për azil, ka rrëfyer përvojën e tij gjatë kalimit të kufirit serbo-hungarez përmes Suboticës në mënyrë të paligjshme me ndihmën e kontrabandistëve. Pasi ka mbërritur në stacionin e autobusëve të Suboticës nga Beogradi, ai dhe qytetarët tjerë të Kosovës ishin ndaluar nga Policia e Serbisë, e cila iu kërkoi të tregojnë letërnjoftimet e tyre. Sipas tij, atyre iu është dashur t'i paguanin 150 euro zyrtarëve policorë serbë në mënyrë që këta të fundit t'ju kthejnë letërnjoftimet emigrantëve kosovarë. Duhet të theksohet se në bazë të të intervistuarit, policia serbe ka qenë e vetëdijshme për qëllimin e tyre për të lëvizur nga Subotica për në Hungari në mënyrë të paligjshme, por përveç se u kishte kërkuar të holla, policia nuk kishte ndërmarrë asgjë për t'i ndaluar ata nga kalimi i paligjshëm i kufirit në drejtim të Hungarisë.⁴⁷ Prej atje, ai mori një taksë që e çoi atë deri në "Villa Lira" në Suboticë dhe e vendosën në kontakt me kontrabandistët në vilë. Ai u shpreh se ishte detyruar që t'ju paguajë 300 euro disa kontrabandistëve me qëllim që të kalonte kufirin me Hungarinë nga Serbia. Pasi arriti të merrej vesh me kontrabandistët, ata e dërguan atë deri në anën serbe të kufirit dhe pohoi se nuk ishte kontrolluar as nga zyrtarë të policisë kufitare serbe e as nga ajo

45 Marrëveshja e Brukselit për Lirinë e Lëvizjes gjendet në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Konkluzionet_0210_liria.pdf. Gjetur më 27 mars 2015.

46 Intervistë me zëvendësministrin e Integritimit Evropian të Kosovës, Ramadan Ilazi, më 13 mars 2015.

47 Intervistë me F.R., azilkërkues i Kosovës, më 12 mars 2015.

hungareze. Ky rrëfim është një nga shumë prej rrëfimeve të personave që janë rikthyer dhe tregojnë se sa e lehtë ishte të kalohej kufiri midis Serbisë dhe Hungarisë në mënyrë të paligjshme.

Në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar dhe kontrabandës me emigrantë, Policia e Kosovës ka arrestuar 98 persona në vitin 2014 me akuzën për kontrabandë të emigrantëve⁴⁸. Në mars të vitit 2015, Policia e Kosovës ndërmori një aksion policor të koordinuar me shtatë vende të tjera evropiane: Francën, Gjermaninë, Republikën e Çekisë, Sllovakinë, Austrinë, Hungarinë dhe Zvicrën, si dhe me mbështetjen e EUROPOL-it e EUROJUST-it u arrestuan 78 persona në këto vende nën dyshimin e bazuar të kontrabandës me emigrantë, falsifikim të dokumenteve dhe aktivitete të tjera të krimit të organizuar. Është e rëndësishme të theksohet se arrestimi i këtij grupi të organizuar të kriminelëve për kontrabandë të emigrantëve kishte shfrytëzuar rrugët nga Kosova dhe Serbia drejt Hungarisë me qëllim të sjelljes së emigrantëve në vendet e tjera evropiane⁴⁹.

3.3. Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Policisë së Serbisë

Migrimi i paligjshëm i qytetarëve të Kosovës përmes Serbisë dhe kontrabanda me emigrantë nëpër Serbi ka vënë në sipërfaqe mungesën e bashkëpunimit në mes të institucioneve të zbatimit të ligjit të të dyja shteteve. Sipas gjetjeve të këtij hulumtimi, nuk ka pasur bashkëpunim ndërmjet kë-

tyre institucioneve, në veçanti në mes të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Serbisë, sidomos gjatë periudhës kritike të migrimit të paligjshëm (tetor 2014 - mars 2015), në parandalimin e migrimit të paligjshëm dhe në luftimin e rrjeteve të kontrabandistëve. Shërbimet policore të të dyja vendeve në përgjithësi nuk kanë bashkëpunim zyrtar për shkak të mosmarrëveshjeve ekzistuese politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të cilat, nga ana tjetër, e pengojnë luftën kundër krimit të organizuar, përfshirë kontrabandën me emigrantë. Bashkëpunimi policor ndërmjet Kosovës dhe Serbisë bëhet me anë të pranisë ndërkombëtare në Kosovë, përkatësisht UNMIK-ut dhe EULEX-it. Vlen të theksohet se Kosova ka arritur marrëveshje ndërkombëtare për bashkëpunim policor me vendet fqinje, me përjashtim të Serbisë⁵⁰.

Sa i përket migrimit të paligjshëm, Policia e Kosovës ka konfirmuar se "nuk kishte asnjë bashkëpunim në mes të Policisë së Kosovës dhe Policisë së Serbisë".⁵¹ Kjo konfirmohet më tej nga zyrtarë të lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, sipas të cilëve, pavarësisht përpjekjeve të Policisë së Kosovës për të bashkëpunuar me Policinë e Serbisë, kjo e fundit nuk ka treguar asnjë vullnet për të bashkëpunuar, veçanërisht në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, kontrabandën me emigrantë dhe në parandalimin e migrimit të

48 Të dhënat janë siguruar nga Policia e Kosovës.

49 (Policia e Kosovës, 2015a).

50 (Kursani, 2015, fq. 6-9).

51 Përgjigje me shkrim (përmes e-mailit) nga Zyra për Media dhe Marrëdhëniet me Publikun e Policisë së Kosovës për QKSS-në, më 12 mars 2015.

paligjshëm.⁵² Sipas tyre, fakti se Serbia nuk ka reaguar, është një tregues se autoritetet e saja në mënyrë të paqëllimshme ndihmuan migrimin e paligjshëm të shtetasve të Kosovës nga Serbia për në Hungari. Në anën tjetër, institucionet serbe, në veçanti Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Serbisë nuk kanë ofruar informata për këtë hulumtim në lidhje me çështjen e mosbashkëpunimit me Policinë e Kosovës në parandalimin e migrimit të paligjshëm dhe në luftën kundër rrjeteve të kontrabandistëve.

Megjithatë, video-materialet që kanë rrjedhur në internet dhe në mediat e Kosovës, tregojnë se disa prej emigrantëve janë transportuar nga Subotica drejt Hungarisë nga ana e Policisë së Serbisë.⁵³ Për më tepër, sipas fotove të publikuara nga mediat shihet se si emigrantët e kaluan anën hungareze të kufirit: në thelb, autoritetet përkatëse në kufirin e Hungarisë nuk i pyesnin emigrantët e Kosovës nëse ishin të pajisur me vizë Shengen për të kaluar kufirin e Hungarisë.⁵⁴

Prandaj, mungesa e bashkëpunimit policor ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në veçanti gjatë valës së fundit të migrimit, si dhe mungesa e mekanizmave parandalues, nëse nuk e lehtësoi, atëherë ndikoi në valën e migrimit nga Kosova. Megjithatë, kjo kryesisht ka të bëjë me shkakun e parë

të përmendur më herët në këtë punim. Si pasojë e kësaj, në gjysmën e parë të muajit shkurt 2015, Gjermania dërgoi 20 zyrtarë policorë në kufirin në mes Hungarisë dhe Serbisë. Kjo kishte për qëllim për të ndaluar migrimin e paligjshëm dhe për të vënë nën kontroll numrin në rritje të azilkërkuësve të Kosovës që shkonin drejt BE-së, kryesisht në Gjermani.⁵⁵ Pas kësaj ndërhyrjeje nga gjermanët, Serbia dhe Hungaria filluan të kontrollojnë kufirin më rreptësisht, dhe si rrjedhojë e kësaj, nisën që t'i arrestojnë emigrantët nga Kosova. Kjo do të thotë se si Serbia, ashtu edhe Hungaria filluan të reagojnë më me seriozitet vetëm pasi patën trysninë e Gjermanisë.⁵⁶ Në përputhje me këto rrethana të krijuara, numri i qytetarëve të Kosovës, që kërkonin azil në shtetet anëtare të BE-së filloi të pësojë rënie në mënyrë të konsiderueshme, në krahasim me periudhat e mëparshme. Gjithashtu, në mars të vitit 2015, institucionet e zbatimit të ligjit të Kosovës dhe të Serbisë filluan bashkëpunimin e tyre. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, i shoqëruar nga zyrtarë të lartë të EULEX-it, zhvilloi një takim në Beograd me homologun e tij nga Policia e Serbisë.⁵⁷ Ata diskutuan për mundësitë e bashkëpunimit në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar ndërkufitar, rritjen e kontrollit kufitar dhe parandalimin e migrimit të paligjshëm. Pavarësisht se ky ishte takimi i parë midis krerëve të shërbimeve policore të të dyja vendeve, kjo megjithatë nuk solli bashkëpunim të mëtejshëm në të ardhmen.

52 Intervistë me drejtorin e Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion në Ministrinë së Punëve të Brendshme të Kosovës, Valon Krasniqi, më 11 mars 2015.

53 Për më shumë hollësi, shih video-materialin në: <https://www.youtube.com/watch?v=P5FDavYVHxQ>. Gjetur më 27 mars 2015.

54 Fotot gjenden në: <http://www.zeri.info/aktuale/18309/kosovaret-e-kalojne-kufirin-pa-syve-te-policise-hungareze-foto/>. Gjetur më 27 mars 2015.

55 (Chambers, 2015).

56 Intervistë me drejtorin e Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion në Ministrinë së Punëve të Brendshme të Kosovës, Valon Krasniqi, më 11 mars 2015.

57 (Policia e Kosovës, 2015b).

4. REKOMANDIME

- Kosova duhet të hapë dialog me shtetet anëtare të BE-së në përpjekje për të përcaktuar marrëveshjet ndërkombëtare që do të mundësonin dhe rregullonin punësimin sezonal të qytetarëve të Kosovës në BE, në përputhje me nevojat e tregut të punës së BE-së.
- Kosova duhet të vazhdojë të punojë në reformimin e ekonomisë dhe të vërë në përdorim masa tjera që janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse për të ulur papunësinë dhe të krijojë vende të reja të punës.
- Institucionet e zbatimit të ligjit/sigurisë të Kosovës dhe të Serbisë, përkatësisht shërbimet policore të të dyja vendeve, si pikënisje, duhet të kenë takime më të shpeshta, të cilat duhet të çojnë drejt bashkëpunimit të dukshëm. Të dyja vendet duhet të ndajnë informata në lidhje me parandalimin e migrimit të paligjshëm dhe bashkërisht të luftojnë rrjetet e krimit të organizuar dhe kontrabandën me emigrantë.
- Kosova dhe institucionet e saj, duke përfshirë ato në nivel lokal dhe qendror, duhet t'i përmbushin kriteret e përcaktuara në udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave dhe ta përgatisin vendin për regjimin pa viza në Zonën Shengen të BE-së. Në anën tjetër, BE-ja duhet të jetë e qartë kur të bëjë vlerësimin për progresin e Kosovës drejt liberalizimit të vizave, pa parimin e ndryshimit të qëllimeve. Për më tepër, Kosova duhet të trajtohet nga BE-ja në të njëjtën mënyrë sikurse pesë vendet tjera të Ballkanit Perëndimor lidhur me integrimin në BE dhe procesin e liberalizimit të vizave.
- Investimet e planifikuara të BE-së në Kosovë, përveç në sundimin e ligjit, duhet të drejtohen në sektorët e prodhimit dhe të industrisë për të krijuar vende të punës sipas parametrave ekzistues strukturorë të punës në Kosovë, dhe më e rëndësishmja, ato investime të orientohen në fushën e arsimit, që në plan afatgjatë, të përgatitë punëtorë me kualifikime të nevojshme për Kosovën dhe BE-në (vende të punës sezonale).

BIBLIOGRAFIA

- Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2013). *Varfëria në konsum në Republikën e Kosovës në vitin 2011*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës. Gjetur më 26 mars 2015, në: http://ask.rks-gov.net/konsumi-i-ekonomive-familjare/publikimet/doc_view/981-varferia-ne-konsum-ne-republiken-e-kosoves-ne-vitin-2011?tmpl=component&format=raw
- Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2015). *Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore 2014 në Kosovë*. Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës. Gjetur më 24 gusht 2015, në: http://ask.rks-gov.net/tregu-i-punes/publikimet/doc_view/1253-rezultatet-e-anketaeumls-saeuml-fuqisaeuml-punaeeuml-tore-2014-naeuml-kosovaeuml?tmpl=component&format=raw
- Chambers, M. (12 shkurt 2015). *German police sent to Serbia-Hungary border to stem Kosovo exodus*. Gjetur më 27 mars 2015, në: <http://www.reuters.com/article/2015/02/12/us-germany-kosovo-migrants-idUSKBN0LG21H20150212>
- Council of the European Union. (16 qershor 2003). *The Thessaloniki agenda for the Western Balkans: Moving towards European integration in Council Conclusions, General Affairs and External Relations, 10369/03 (Presse 166)*. Gjetur më 24 shkurt 2015, në: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/gena/76201.pdf
- Deklarata e Komisionarit të BE-së për Migrim, Punë të Brendshme dhe Shtetësi, Dimitris Avramopoulos në Prishtinë*. (10 mars 2015). Gjetur më 14 mars 2015, në: <https://www.youtube.com/watch?v=BSt6Sa0wtns>
- Deklarata e Komisionarit të BE-së për Politikën e Fqinjësisë Evropiane dhe Negociatave për Zgjerim, Johannes Hahn në Prishtinë*. (25 mars 2015). Gjetur më 25 mars 2015, në: https://www.youtube.com/watch?v=IMjJt_Gaxll
- EU Perspective in Kosovo & UBO Consulting. (2014). *Survey of Awareness of the EU and European Integration in Kosovo*. Gjetur më 26 mars 2015, në: [http://www.mei-ks.net/repository/docs/2014_Survey_of_Awareness_of_the_EU_and_European_Integration_in_Kosovo_\[EUPK\]_%28Final%29\[1\].pdf](http://www.mei-ks.net/repository/docs/2014_Survey_of_Awareness_of_the_EU_and_European_Integration_in_Kosovo_[EUPK]_%28Final%29[1].pdf)
- European Commission. (15 korrik 2009). *Proposal for a Council Regulation amending Regulation (EC) No 539/2001 listing the third countries whose nationals must be in possession of visas when crossing the external borders and those whose nationals are exempt from that requirement*. Gjetur më 1 mars 2015, në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2009:0366:FIN:EN:PDF>

- European Commission. (14 qershor 2012a). *Press release - Commission delivers visa roadmap to Kosovo government*. Gjetur më 24 shkurt 2015, në: http://europa.eu/rapid/press-release_IP-12-605_en.htm
- European Commission. (19 janar 2012b). *Press release - Commission launches dialogue with Kosovo on visa free travel*. Gjetur më 25 shkurt 2015, në: http://europa.eu/rapid/press-release_IP-12-32_en.htm
- European Commission. (24 korrik 2014a). *COM(2014) 488 final - Report from the Commission to the European Parliament and the Council-Second report on progress by Kosovo in fulfilling the requirements of the visa liberalisation roadmap*. Gjetur më 24 shkurt 2015, në: http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/news/docs/second_commission_assessment_en.pdf
- European Commission. (2014b). *{COM(2014) 488 final} - Commission Staff Working Document accompanying the Report from the Commission to the European Parliament and the Council-Second report on progress by Kosovo in fulfilling the requirements of the visa liberalisation roadmap*. Bruksel. Gjetur më 16 mars 2015, në: http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/news/docs/accompanying_staff_working_document_en.pdf
- European Commission. (20 shkurt 2015a). *Live Midday statement by Commissioner Johannes Hahn*. Gjetur më 26 mars 2015, në: <http://ec.europa.eu/avservices/video/player.cfm?ref=1099303&sitelang=en&videolang=en>
- European Commission. (18 shkurt 2015b). *Main challenges to be addressed to ensure Kosovo and the EU grow closer together - Speech by Commissioner Hahn at the meeting with Prime Minister Isa Mustafa and Government*. Gjetur më 23 mars 2015, në: http://europa.eu/rapid/press-release_SPEECH-15-4450_en.htm
- European Union Office in Kosovo. (14 qershor 2012). *Visa Liberalisation with Kosovo - Roadmap*. Gjetur më 1 mars 2015, në: http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_travel/visa_liberalisation_with_kosovo_roadmap.pdf
- European Union Office in Kosovo. (13 janar 2015). *Kosovars risk undertaking considerable expenses only to be sent back to Kosovo (13/01/2015)*. Gjetur më 27 mars 2015, në: http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/press_corner/all_news/news/2015/20150113_en.htm
- Eurostat. (2015a). *Asylum applicants and first instance decisions on asylum applications: 2014*. Gjetur më 21 mars 2015, në: <http://ec.europa.eu/eurostat/documents/4168041/6742650/KS-QA-15-003-EN-N.pdf/b7786ec9-1ad6-4720-8a1d-430fcfc55018>

- Eurostat. (18 qershor 2015b). *Thirty main citizenships of first time asylum applicants by destination country in the EU 28, 1st quarter 2015*. Gjetur më 23 qershor 2015, në: http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/images/6/65/Thirty_main_citizenships_of_first_time_asylum_applicants_by_destination_country_in_the_EU_28%2C_1st_quarter_2015.png
- Eurostat. (18 qershor 2015c). *First time asylum applicants in the EU-28 by citizenship, Q1 2014 – Q1 2015*. Gjetur më 24 qershor 2015, në: http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/images/6/65/Thirty_main_citizenships_of_first_time_asylum_applicants_by_destination_country_in_the_EU_28%2C_1st_quarter_2015.png
- Garaiova, A., & Merja, A. (2012). *Kosovo and Visa-free travel regime: The increasing EU Member States' scepticism and regional experiences*. Prishtinë: Group for Legal and Political Studies. Gjetur më 2 mars 2015, në: <http://legalpoliticalstudies.org/download/Policy%20Report%2005%202012%20eng.pdf>
- Group 484 and Nexus. (2012). *Irregular can be regular - Migration from southern Serbia*. Belgrade: Group 484. Gjetur më 3 qershor 2015, në: <http://www.grupa484.org.rs/sites/default/files/Irregular%20can%20be%20Regular%20-%20Migration%20from%20southern%20Serbia,%202012.pdf>
- Infokusi. (10 janar 2015). *Skandaloze: Policia serbe trafikon Shqiptarët për Hungari*. Gjetur më 27 mars 2015, në: <https://www.youtube.com/watch?v=P5FDAvYVHxQ>
- Kqiku, M. (16 shkurt 2015). *Ministri Çollaku Këput Shpresat e Kosovarëve për Liberalizim të Vizave Këtë Vit*. Gjetur më 25 mars 2015, në: <http://live.kallxo.com/sq/MTL/Ministri-Collaku-Keput-Shpresat-e-Kosovareve-per-Liberalizim-te-Vizave-Kete-Vit-4898>
- Kursani, S. (2015). *Bashkëpunimi policor mes Kosovës dhe Serbisë*. Beograd dhe Prishtinë: Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë & Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Gjetur më 15 shtator 2015, në: http://www.qkss.org/repository/docs/Bashkepunimi_policor_ne_mes_te_Kosoves_dhe_Serbise_856214.pdf
- Kuvendi i Kosovës. (2015). *Rezolutë për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës*. Gjetur më 27 mars 2015, në: http://kuvendikosoves.org/common/docs/Rezolute_per_pengimin_e_migrimit_ilegal_te_qytetareve_te_Kosoves.pdf
- Merja, A. (2012). *Visa Liberalization Process in Kosovo: A prologue to achievements, challenges and needs*. Prishtinë: Group for Legal and Political Studies. Gjetur më 2 mars 2015, në: <http://legalpoliticalstudies.org/download/Policy%20Note%2003%202012%20eng.pdf>
- Ministria e Integritimit Evropian të Kosovës. (5 qershor 2015). *Ministri Çollaku dorëzon Raportin mbi përmbushjen e kriterëve për liberalizim të vizave tek përfaqësuesi i BE-së*. Gjetur më 8 qershor 2015, në: <http://www.mei-ks.net/>

sq/lajmet/ministri-collaku-dorezon-raportin-mbi-permbushjen-e-kriter-eve-per-liberalizim-te-vizave-tek-per-faqesuesi-i-be-se

- Möllers, J., Arapi-Gjini, A., Xhema, S., & Herzfeld, T. (2015). *Mass exodus from Kosovo: How a struggling state loses its citizens*. Leibniz Institute of Agricultural Development in Transition Economies (IAMO). Gjetur më 2 shtator 2015, në: http://www.iamo.de/fileadmin/documents/IAMOPolicy-Brief24_en.pdf
- Policia e Kosovës. (25 mars 2015a). *Në operacionin e përbashkët të tetë (8) shteteve, në mbështetje nga EUROPOL-i dhe EUROJUST-i, arrestohen shtatëdhjetë e tetë (78) persona*. Gjetur më 27 mars 2015, në: <http://www.kosovopolice.com/sq/informacione/ne-operacionin-e-perbashket-te-tete-8-shteteve-ne-mbeshtetje-nga-europoli-dhe-eurojusti-arrestohen-shtatedhjetete-e-tete-78-persona-nendyshimin-e-bazuar-per-kontrabandim-te-mig>
- Policia e Kosovës. (11 mars 2015b). *Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, i shoqëruar nga zyrtarë të lartë të EULEX-it, realizoi një takim me homologun e tij në Beograd*. Gjetur më 27 mars 2015, në: <http://www.kosovopolice.com/sq/informacione/drejtori-i-pergjithshem-i-policise-se-kosoves-i-shoqeruar-nga-zyrtare-te-larte-te-eulex-it-realizoi-nje-takim-me-homologun-e-tij-ne-beograd>

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. (2014). *Barometri Kosovar i Sigurisë Edicioni i katërt*. Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Gjetur më 26 mars 2015, në: http://www.qkss.org/repository/docs/Barometri_Kosovar_i_Sigurise_-_Edicioni_i_katert_515028.pdf

Telegrafi. (16 shkurt 2015). *Mustafa: Nuk kam shkuar te Stacioni i Autobusëve, sepse ata që ikin kishin edhe iPhone*. Gjetur më 27 shkurt 2015, në: <http://www.telegrafi.com/lajme/mustafa-nuk-kam-shkuar-te-stacioni-i-autobuseve-sepse-ata-qe-iknin-kishin-edhe-iphone-2-58794.html>

Xharra, B. (3 shkurt 2015). *Kosovarët e kalojnë kufirin para syve të policisë hungareze (FOTO)*. Gjetur më 27 mars 2015, në: <http://www.zeri.info/aktuale/18309/kosovaret-e-kalojne-kufirin-para-syve-te-policise-hungareze-foto/>

Zyra e Kryeministrit të Kosovës. (2011). *Konkluzat e dakorduara 2 korrik 2011 Marrëveshja për Lirinë e Lëvizjes*. Gjetur më 27 mars 2015, në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Konkluzionet_0210_liria.pdf

Zyra e Kryeministrit të Kosovës. (18 shkurt 2015). *Fjala e kryeministrit Mustafa në konferencën e përbashkët për media me komisionerin e BE-së, Johannes Hahn*. Gjetur më 29 maj 2015, në: <http://www.kryeministri-ks.net/?page=1,9,4757>

INTERVISTAT

F.R. (12 mars 2015), azilkërkues i Kosovës.

Ramadan Ilazi (13 mars 2015),
zëvendësministër i Integritimit Evropian
të Kosovës.

Sefedin Kuçi (11 mars 2015), udhëheqës i
Divizionit për Planifikim, Strategji dhe
Statistika në Ministrinë e Punëve të
Brendshme të Kosovës.

Valon Krasniqi (11 mars 2015), drejtor i
Departamentit për Shtetësi, Azil dhe
Migracion në Ministrinë e Punëve të
Brendshme të Kosovës.

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

327(4/9:496.51)

314.74

Avdiu, Plator

Largimi drejt shteteve anëtare të BE-së: shkaqet dhe pasojat e migrimit të fundit nga Kosova / Plator Avdiu. – Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2015. – 27 f. : ilustr. me ngjyra ; 21 cm.

Bibliografia : f. 22-26

ISBN 978-9951-679-29-9

ISBN 978-9951-679-29-9



9 789951 679299

www.qkss.org